



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.12

Prishtinë, më 14.2.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekalju, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Mungoi: Verica Qeraniq.

Të ftuar: Alush Istogu, Qamile Sinanaj dhe Murteza Osdautaj, përfaqësues të MASHT-it.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të KDI-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.2.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-053 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA REF. NO. 8116-00/2016 LR 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.2.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 6.2.2018 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë;

Ismail Kurteshi, kryetar, në fillim të mbledhjes tha se Projektligji për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë, i ka plotësuar kushtet për shqyrtim para miratimit në parim dhe kërkoi nga përfaqësuesit e MASHT-it arsyetimin për projektligjin.

Alush Istogu, tha se qëllim i Projektligjit për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë, është rregullimi i fushës së inovacionit, transferit dhe të dijes, kriteret dhe për zhvillimin e tyre si dhe mbrojtja e interesit publik e shkencor në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në vijim Istogu foli për përgjegjësitë e MASHT-it dhe ministritë e linjës për hartimin e politikave dhe strategjive që planifikojnë dhe nxisin zhvillimin e kapaciteteve në fushën e inovacioneve shkencore.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj tha se në buxhetin e vitit 2018-2019, nuk është paraparë planifikim buxhetor për këtë projektligj dhe a do të kërkohet buxhet shtesë gjatë rishikimit të buxhetit në lidhje me implementimin e tij, si dhe kërkoi sqarim lidhur me ministritë e linjës të cilat ndërlidhen me këtë projektligj.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se në projektligj nuk ka vërejtur fjalën ndëshkim apo ndonjë term tjetër si masë ndëshkuese, i cili do duhej të përdoret në rast të mospërmbushjes së obligimeve të parapara në rast të caktuar, dhe se e përkrahë në parim projektligjin.

Nezir Çoçaj, tha se e përkrahë projektligjin dhe se MASHT-i do të duhej ta parasheh buxhet për këtë projektligj mbase i njëjti edhe do të përkrahet edhe nga partnerët e jashtëm. Ai shprehi shqetësimin lidhur me përkufizimet në nenin 2, pika 1.1, si dhe pika 1.5. dhe në lidhje me këtë kërkoi sqarim nga përfaqësuesit e ministrisë.

Ismajl Kurteshi, theksoi se gjatë implementimit të projektligjit ka implikime të institucioneve tjera dhe kërkoi sqarim në lidhje me mekanizmat që do të implikohen në implementimin e tij.

Alush Istogu, në vijim dha sqarimet për çështjet e ngritura. Sa i përket buxhetit, ai tha se MASHT-i ka planifikuar kosto buxhetore si dhe do të kërkojë partnerë tjerë për implementimin e

këtij ligji, kurse sa i përket termit të ministritë e linjës është përdorur ky term më qëllim që mos të ndryshohet ligji në rast të emërtimit të ministrive.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit me 10 vota për, miratuan në parim Projektligji nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë dhe Kuvendit, i paraqesin këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr.06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-053 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA REF. NO. 8116-00/2016 LR 2016;

Ismajl Kurteshi, tha se Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA është i shkurtër, përmban gjithsejtë tre nene, ndërsa kërkoi sqarim lidhur me pikat e Marrëveshjes e nënshkruar nga MASHT-i, konkretisht neni 2, 3, 5 dhe 9.

Alush Istogu, tha se MASHT-i në kuadër të Strategjisë së Arsimit 2017/2021 ka planifikuar objektivat e fushës së arsimit, andaj për realizimin e objektivave është i nevojshëm bashkëpunimi me partnerë dhe lidhur me këtë është arritur marrëveshje mes MASHT-it dhe ADA-s austriake. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA, është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka për qëllim përkrahjen dhe interesin e përgjithshëm të fushës së arsimit të lartë.

Ratifikimi i Marrëveshjes së mirëkuptimit për programin e Projektit që do të financohet nga ADA dhe MASHT-i, me një kohëzgjatje të planifikuar prej 36 muajve, ku MASHT-i participon me 200.000 euro, ndërsa ADA-ja austriake me 1.800.000 euro.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj kërkoi sqarim rreth partnerit implementues të kësaj marrëveshjeje.

Arbërie Nagavci, tha sa bashkëpunimi me ADA-në është i një rëndësie të veçantë duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm. Gjithashtu, ajo kërkoi sqarim lidhur me termin e partnerit implementues në marrëveshje si dhe kërkoi të dijë a do të ketë konkurse apo shpallje publike lidhur me përfitimet nga kjo marrëveshje.

Adem Mikullovc, tha se marrëveshje të tilla për studime të mos fokusohen vetëm në Austri, por të shikohet mundësia edhe në vende tjera.

Përfaqësues të MASHT-it sqaruan në lidhje me çështjet e ngritura, sa i përket gabimeve teknike gjatë përkthimit të marrëveshjes, partnerët implementues të kësaj marrëveshjeje janë aktorët e

fushës së arsimit të lartë, përmes projekteve të tyre strategjike, të cilët do të përfitojnë në ngritjen e kapaciteteve hulumtuese, bursa për studime të doktoratës dhe postdoktoratës. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, MASHT-i do të hartojë planin e veprimit, termat e referencës, shpalljen publike për projekte të cilat do të bëhen bashkërisht me ADA-në austriake.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit me 10 vota për, miratuan Projektligjin nr.06/L-053 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA REF. NO. 8116-00/2016 LR 2016 dhe Kuvendit, i paraqesin këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr.06/L-053 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim ADA REF. NO. 8116-00/2016 LR 2016.

5. Të ndryshme.

Teuta Haxhiu, ngriti çështjen e procesit edukativo-arsimor në Qendrën Korrektuese në Lipjan, konkretisht në lidhje me organizimin e provimit të maturës në këtë institucion si dhe mundësinë e vazhdimit të shkollimit të lartë.

Lidhur me këtë çështje u përgjigjen përfaqësuesit e MASHT-it, të cilët thanë se ministria në bashkëpunim me Qendrën Korrektuese në Lipjan është duke e trajtuar çështjen e arsimit parauniversitar, i cili është edhe i obliguar, ndërsa sa i përket arsimit të lartë për këtë kategori, thanë se ligji nuk e obligon MASHT-in për organizimin e këtij niveli arsimor.

Ismajl Kurteshi, diskutoi lidhur me përgatitjet për organizimin e tryezës e cila është planifikuar të mbahet më 27 shkurt 2018 dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të japin propozime konkrete për listën e të ftuarve. Më tej, Kurteshi tha se në këtë tryezë do të diskutohen çështjet që kanë të bëjnë me arsimin parashkollor dhe në fund do të nxirren rekomandime që do të procedohen në MASHT.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi